



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.05.2022, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KOMPANISË RAJONALE TË
MBETURINAVE "PASTRIMI" SHA NË PRISHTINË

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" SHA në Prishtinë.

II.

Shuma e mjeteve të ndara sipas pikës I të këtij vendimi, është 100.000 € (njëqindmijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme, mjete nga të hyrat vetanake.

III.

Qëllimi i këtij Vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II për kryerjen e obligimeve ndajë deponisë sanitare të Mirashit - Prishtinë.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-400/01-104007/22, më 12.05.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

